

Shembulli i faqes së parë Qendra Komunale e Biznesit SUHAREKË

**Keni nevojë për ndihmë për biznesit tuaj?
Mendoni të hapni biznesin tuaj?**



Kjo broshurë do ju ofroj juve ndihmë dhe udhëzime rreth të gjitha aspekteve të lidhura me fillimin ose operimi e një biznesi në Kosovë. Të përfshira janë udhëzimet hap pas hapi për regjistrim dhe procedura tjera të cilat janë të kërkuara me ligj.

Stafi i QKBM gjithashtu mund të ju ofroj udhëzime dhe këshilla si dhe të kujdeset për regjistrimin dhe për kërkesat tjera administrative që kanë të bëjnë me biznesin tuaj.

**Ju mund t'i kurseni vetit kohë dhe para duke përdorur këtë broshurë.
Mbani në mend, stafi i QKB-së do të bëjnë më të mirën e tyre për tu përgjigjur në të gjitha pyetjet që ju mund ti keni, kështu që ju lutemi pyetni.**

Treguesit

1. Parathënie
2. Themelimi i një Biznesi Individual apo të një Ortakërie të Përgjithshme
3. Udhëzimet hap pas hapi për regjistrimin e një Biznesi Individual apo të një Ortakërie të Përgjithshme
4. Themelimi i një Ortakërie të Kufizuar apo i një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar
5. Udhëzimet hap pas hapi për regjistrimin e një Ortakërie të Kufizuar apo të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar
6. Themelimi i një biznesi kooperativë
7. Regjistrimi i ndryshimeve në Bizneset Ekzistuese
8. Terminologjia e zakonshme e biznesit
9. Shpjegime rreth tatimit për bizneset
10. Numri fiskal
11. Shpjegimi i TVSH- së
12. Udhëzime për marrjen e lejeve komunale
13. Udhëzime për marrjen e licencave komunale
14. Udhërrëfyesi për Funkcionimin e Zyrës së Pengut
15. Lista e Kodeve të bizneseve dhe shënime udhëzuese
16. Përshkrimi i formularëve
17. Organizatat këshilluese të biznesit
18. Lista e publikimeve për t'ju ndihmuar për arritjen e suksesit në biznes.
19. Shablloni i planit të biznesit
20. Huamarrja financiare nga një bankë
21. Çka është “leasing”

1. Parathënie

Kjo broshurë është e krijuar për të dhënë sa më shumë informata që është e mundur rreth biznesit në Kosovë dhe për jep udhëzime për procedurat të cilat do të ju ndihmojnë ju për të arritur sukses të biznesit tuaj.

Ju mund të jeni në fillim të biznesit, që në vete është një hap i madh dhe përfshin marrjen e shumë rreziqeve dhe shqetësime. Ose ju mund të jeni një ekspert biznesi por keni nevojë të ndryshoni drejtimin e biznesit tuaj. Cilat do qofshin rrethanat e biznesit tuaj, në këtë broshurë do të jenë informatat të cilat do ju kursejnë kohë, para dhe shqetësime.

Këshilloheni ta lexoni me kujdes udhëzuesin hap pas hapi, i cili përshkruan bazat për themelimin e bizneseve të ndryshme dhe hapat që kërkohen për të themeluar dhe regjistruar biznesin në mënyrë ligjore. Gjithashtu ka edhe shënime udhëzuese për forma të ndryshme që ju mund ti hasni varësisht nga statusi i biznesit tuaj.

Përveç kësaj ka edhe këshilla për tatime, TVSH dhe termave të përdorura në biznes që do të ju ndihmojnë juve për të kuptuar disa nga zhargonet e përdorura në biznes. Staf i QKB-së tuaj lokale do të jetë i gatshëm për të ju ndihmuar juve me pyetjet që ju mund ti keni në lidhje me biznesin tuaj kështu që mos hezitoni të pyetni.

Shumë njerëz të cilët ose janë në biznes ose janë duke u përgatitur për të filluar një biznes nuk shqetësohen (apo nuk din si) të kërkojnë këshilla apo për të bërë çfarëdo lloj plani për të testuar idetë e tyre. Kjo shumë shpeshti qon në dështim të biznesit dhe zhgënjim. Në Kosovë ekzistojnë organizata të cilat mund të ju ndihmojnë juve për të planifikuar dhe testuar realizueshmërinë e një biznesi të ri apo/dhe ofrojnë ndihmë për të kaluar vështirësitë e biznesit.

Ju nuk do të merrnit një udhëtim të gjatë pa planifikuar në detaje mënyrat më të mira dhe më ekonomike për të mos rrezikuar me biznesin tuaj. Përdorni këshillat që ekzistojnë dhe planifikoni me kujdes. Paçi fat me biznesin e juaj, nëse ju jeni të përgatitur mirë fati do të luaj vetëm një pjesë të vogël në suksesin tuaj.

Kjo informatë gjithashtu është në dispozicion edhe në faqen komunale të internetit në: www.mitrovice.gov-ks.org

2. Themelimi i Biznesit Individual apo Ortakërisë së Përgjithshme

Ky lloji i njësisë të biznesit është për një apo më shumë persona që fillojnë një biznes të vogël si pronar(ët) i vetëm, që mund kenë një numër të vogël punëtorësh apo fare të mos kenë. Është forma më e thjeshtë e njësisë ligjore dhe është e rekomandueshme kur vlera e investimeve në biznes nuk është aq e madhe dhe transaksionet që bëhen gjatë rrjedhjes së biznesit nuk përfshijnë rrezik të madh financiar. Zakonisht llojet e biznesit që themelohen si biznes individual janë dyqane të vogla, autolarje, kontroll teknik i veturave, robaqepëse, këpucëtar e kështu me rralë.

Ekzistenca e këtij lloji të biznesi do të thotë që individi apo partnerët kanë përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet. Kjo do të thotë që nëse biznesi mbyllet apo falimenton, kreditorët mund ta kërkojnë të gjithë borxhin e tyre nga personi apo partnerët që janë pronar të biznesit. Kjo do të thotë që pronarëve ndoshta do të ju duhet ta shesin pronën private për t'i mbuluar borxhet. Gjithashtu në rast të një partneritetit, partnerët i ndajnë përgjegjësit për borxhet e biznesit të njëri-tjetrit, kështu nëse njëri partner nuk mund ta paguan borxhin e tij/saj partneri(rët) tjerë janë përgjegjës për ta paguar.

Krijimi ligjor i këtij lloji të biznesi është mjaftë e lehtë në Kosovë (shiko më poshtë udhëzuesin hap pas hapi). Pastaj në baza vjetore është vetëm një numër i vogël i dokumentacionit të nevojshëm për tu plotësuar (shiko udhëzime për formularët). Nëse biznesi juaj ka shitje mbi 50,000 € ju duhet ta paguani TVSH (shiko pjesën e TVSH-së). Në përgjithësi, ju do të jeni të obliguar të paguani tatimin në shitje me një vlerë prej 5% çdo tre muaj (shiko udhëzuesin e tatimit). Konsulenti i QKB-së do tua shpjegon në detaje të mëtejshme.

3. Udhëzimet hap pas hapi për regjistrimin e një Biznesi Individual apo të një Ortakërie të Përgjithshme

Sipas ligjit hapi i për që ju duhet të bëni është të regjistroni biznesin, kështu që ju mund ta merrni një numër zyrtar të regjistrimit dhe informatat tuaja do të ruhen nga Komuna dhe Agjencia e Regjistrimit të Biznesit Kosovë (ARBK). Para se të fillon ju sugjerojmë të konsultoheni me një qendër këshilluese të biznesit, në mënyrë që një këshilltar (pa para) mund të vlerësoj zbatueshmërinë e biznesit tuaj.

Hapi 1 Ju duhet të keni dokumentet dhe informatat e më poshtme:

Lejen e njoftimit të pronarit(ëve)

Kontrata e marrëveshjes tuaj për qira të lokalit me një palë të tret nga të cilët ju e keni marr me qira lokalet, apo dokumentet e pronësisë së lokalit.

Si dhe letërnjoftimi i qiradhënësit

Numrin i doganës dhe kopja e licencës, VETËM nëse jeni importues apo eksportues.

Emrat, detajet e ID-së, adresat e pronarëve të biznesit, drejtorëve apo të bashkëpronarëve

Nëse e përdorni:

Auditorët, kontabilistë dhe/apo agjentët e regjistruar- Ju duhet ti shkruani emrat e tyre, adresat dhe detajet e lejeve të tyre të njoftimit.

NËSE JU NUK I KENI KËTO INFORMATA NUK DO TË JETË E MUNDUR TA PLOTËSONI FORMULARIN

Hapi 2 Ju duhet të vendosni për kodin e aktiviteti tuaj që është i aplikueshëm për biznesin tuaj. Këtë mund ta bëni duke shikuar listën e kodeve (faqen xx në broshurë), do të ju ndihmojë këshilluesi i QKB-së.

Hapi 3 Plotësoni formularin B që mund të merret nga stafi i QKB-së apo të printohet nga faqja e internetit e ARBK-së. Një pjesëtar i stafit të QKB-së mund t'ju këshilloj se si mund ta plotësoni këtë formularë. Gjithashtu shikoni faqen xx që e shpjegon këtë formularë. Nëse i keni të gjitha informatat e përshkruar në hapin 1, plotësimi i formularit nuk duhet të jetë problem. Ndiqni me kujdes shënimet për ndihmë në faqen xx.

Hapi 4 Tani duhet të bëhet një pagesë prej 7 €. Për këtë shumë ju kërkoni një faturë nga QKB-ja. Kjo faturë e QKB-së duhet të dërgohet në bankë dhe të paguhet shuma (si dhe pagesa e bankës) në llogarinë e caktuar. Banka do ju jap juve një faturë e cila përdoret si dëshmi e pagesës në QKB.

Hapi 5 Pasi të jenë plotësuar formularët atëherë së bashku me dokumentet tuaja mund të paraqiten në QKB që ata të mund të kontrollojnë a është çdo gjë në rregull.

Hapi 6 Dokumentet tuaja do të procedohen nga stafi dhe pastaj në mënyrë elektronike (përmes kompjuterit) do të dërgohen për tu aprovuar nga ARBK-ja. Nëse ARBK-ja e pranon aplikacionin ata do ta njoftojnë QKB-në. Pastaj QKB-ja do ta shtyp certifikatën origjinale të regjistrimit. (ARBK-ja menjëherë informon autoritet e Tatimeve dhe Doganave për regjistrimin tuaj dhe për numrin tuaj unik të biznesit)

Hapi 7 Certifikata e regjistrimit do të vuloset nga QKB-ja dhe ju do të merrni një faturë që konfirmon marrjen e dokumentit tuaj. (QKB-ja do të ju informoj juve se kur do ta merrni certifikatën).

Hapi 8 Tani juve do të ju duhet të merrni një leje nga Komuna që ju jep leje për të filluar biznesin, nëse çdo gjë është në rregull. Stafi i QKB-së do të kontakton me departamentin përkatës të lejeve dhe do të cakton vizitën e inspektorin të lejeve në adresën tuaj të biznesit. (Shiko udhëzuesin për leje) Ju duhet të pajtoheni me këtë marrëveshje.

Hapi 9 Stafi i QKB-së do të ju këshilloj juve rreth marrjes së një licence që varësisht nga biznesi i juaj mund të jetë apo të mos jetë e nevojshme (shikoni faqen e Udhëzimeve për Licenca Biznesi) Pasi që kjo ka gjasa të kërkojë të kontaktoni me Ministrinë, QKB-ja juaj do ju këshilloj se si ta bëni këtë.

Shënim

Ka gjasa që pas themelimit të biznesit tuaj në një pikë në të ardhmen, ju të keni nevojë për të bërë ndryshime. Ndryshimet në biznes mund të bëhen për disa arsye, për shembull rritet biznesi dhe duhet të punësoni më shumë punëtorë, një drejtorë jep dorëheqje, për shkak të rritjes së biznesit përfshihen më shumë drejtor, apo një kompani e huaj ka dëshirë të investoj. ARBK-ja duhet të njoftohet për ndryshimet e caktuara të biznesit, duke i dorëzuar atyre dokumentet e nevojshme. Në paragrafin xx ju mund të shihni se për të cila ndryshime në biznesin tuaj ju duhet ta informoni ARBK-në. Procesi i dorëzimit të dokumenteve mund të përfundohet në QKB.

4. Themelimi i një Ortakërie të Kufizuar apo të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar

Çka është Ortakëria e Kufizuar?

Ndryshe nga bizneset individuale, që kryesisht janë në pronësi të një personi, ortakëria e kufizuar është biznes ku pronësia është e x njerëzve të caktuar të cilët kanë pranuar që të kenë një përqindjen të biznesit. Një Ortakëri e Kufizuar (OK) është e njohur nga ligji si njësi individuale, që i nënshtrohet ligjeve të veçanta që janë projektuar për ti mbrojtur të drejtat e partnerëve dhe të gjithë organeve të jashtme që bashkëveprojnë me OK- në.

Në këtë lloj të “Ortakërisë së Kufizuar” nëse biznesi mbyllet apo falimenton, pronarët me ligj janë të detyruar të paguajnë vlerën e aksioneve të tyre çdo kreditori. Në këtë mënyrë “përgjegjësia” e biznesit është e “kufizuar” në vlerën e secilit nga aksionarët. Nëse borxhi në mbyllje të biznesit është më i madh se totali i aksioneve atëherë edhe pronat e biznesit do të shiten për të paguar kreditorët.

Themelimi i një Ortakërie të Kufizuar rekomandohet kur një numër i vogël i njerëzve duan të ndajnë pasurin e biznesit, me ç’rast aksionet e tyre dhe përgjegjësitë në biznes janë të bërë të qarat dhe të rregulluara me ligj.

Për shembull 5 persona pajtohen të fillojnë një biznes por investojnë shuma të ndryshme, secili nga ortakët A dhe B vënë nga 30%, totali 60%, ortakët C+D investojnë secili nga 15%, totali 30%, ortaku E investon 10% e mbetur. Kjo ndarje e aksioneve duhet të jetë ligjërisht e deklaruar kur të bëhet regjistrimi i biznesit. Për këtë arsye ortakët A+B kanë më shumë të drejta ligjore për të ndikuar në politikat e kompanisë. Ndarja e fitimeve që dalin nga kompania gjithashtu janë të ndara sipas numrit të aksioneve që i zotërojnë.

Themelimi i një biznesi si Ortakëri e Kufizuar gjithashtu rekomandohet kur rreziqet financiare të biznesit janë mjaftë të larat, për shembull një biznes i ri në fillim investon një shumë të konsiderueshme të parave në pajisje, dhe periudha për gjenerimin e të ardhurave për të paguar huat dhe për të mbuluar shpenzimet e biznesit është mjaft e gjatë. Ky tip i financimit “ekspozues” është normal dhe shpesh rrezik i nevojshëm për të filluar biznesin. Sidoqoftë planifikimi i kujdesshëm paraprakisht mund të ulë në minimum rrezikun dhe të zvogëloj elementin surprizë të shpenzimeve të paparashikuara.

Çdo tre muaj prej datës së regjistrimit ju duhet të dërgoni autoriteteve Tatimore llogarinë tuaj së bashku me pagesën prej 5% të shitjeve tuaja (Shiko Udhëzimet për Tatim). Nëse shitjet tuaja vjetore janë të paktën 50,000 € juve gjithashtu do të ju duhet të regjistroheni te autoritet e TVSH-së, kjo është e barabartë me rreth 1000€ në muaj (Për detaje shikoni Udhëzimin për TVSH)

Ju këshillojmë të konsultoheni me një avokat para se të themeloni këtë lloj kompanie. Avokati do të hartoj marrëveshjen e kompanisë tuaj e cila e përcakton pozitën dhe të drejtat ligjore të aksionarëve, kjo është me rëndësi të veçantë në rast të ndonjë mosmarrëveshje në mes aksionarëve. Për fat të keq mosmarrëveshjet në mes partnerëve të biznesit nuk janë të pazakonshme kështu që marrëveshjet ligjore në fillim janë më së e të këshillueshme.

5. Udhëzimet hap pas hapi për regjistrimin e një Ortakërie të Kufizuar apo të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar

Regjistrimi – Ky regjistrim vlen për Ortakëri të Kufizuar, Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare dhe të Kompani të Huaj

Hapi 1 Para se të filloni procedurën e regjistrimit ju duhet ti keni informatat dhe dokumentet e mëposhtme.

Emrat dhe adresat, detajet e kontakteve, letërnjoftimet e të gjithë pronarëve.

Emrat dhe adresat, detajet e kontakteve, letërnjoftimet e të gjithë Drejtorëve dhe të personave me pozitë në kompani varësisht prej llojit të aksioneve të tyre.

Emrin dhe adresa, detajet e kontaktit, letërnjoftimi i një agjenti apo përfaqësuesi që ju e përdorni për të regjistruar biznesin.

Deklaratën e agjentit te regjistruar

Kontrata e marrëveshjes për qira të lokalit tuaj me një palën e tretë nga i cili ju mund të merrni lokalit me qira, apo dokumentet e pronësisë së lokalit tuaj, letërnjoftimi i qiradhënësit

Numri i doganës dhe kopja e licencës, VETËM nëse ju tanimë jeni importues apo eksportues.

Numrin e TVSH-së (vetëm nëse tanimë jeni të regjistruar, shiko udhëzimin për TVSH)
 Numri i aksioneve të lëshuara dhe vlera e aksioneve.
 Klasa(t) e aksioneve
 Statuti i SH.P.K-së
 Aktivitetet kryesore të biznesit dhe çdo nën-aktivitete(aktivitet sekondar)
 Detajet e çdo dege të biznesit-numrin e telefonit, adresën dhe dokumentet e pronësisë
 Web-faqen dhe E-mail adresën

NËSE JU NUK I KENI KËTO INFORMATA NUK DO TË JETË E MUNDUR TA PLOTËSONI FORMULARIN

Hapi 2 Ju duhet të vendosni për kodin e aktivitetit që është i zbatueshëm për biznesin tuaj kryesor, dhe gjithashtu të çdo dege që ju mendoni të keni. Kjo e fundit mund të ketë aktivitet tjetër biznesi kështu që sigurohuni që e keni shënuar sakët numrin e kodit. Ju mund ta bëni këtë duke e shikuar listën e kodeve(faqja xx në këtë broshurë), konsulenti i QKB-së do të ju ndihmoj.

Hapi 3 Plotësoni formularin A0 të aplikimit i cili mund të merret nga stafi i QKB-së apo të printohet nga faqja e internetit të ARBK-së. Një pjesëtar i stafit të QKB-së mund të ju këshilloj ju se si ta plotësoni këtë formularë. Shiko gjithashtu faqen xx që e shpjegon këtë formularë. Nëse ju i keni të gjitha informatat e përshkruara në Hapin 1, plotësimi i formularit nuk duhet të jetë problem. Ndiqi me kujdes shënimet ndihmëse në faqen xx.

Hapi 4 Kur të plotësohet formulari së bashku me dokumentet tuaja ju mund t'i dorëzoni në QKB në mënyrë që ata të mund t'i kontrollojnë se çdo gjë është në rregull dhe të bëjnë kopjet e nevojshme. Në këtë fazë gjithashtu kërkohet pagesa prej 22 € paguar në Bankë.

Hapi 5 Dokumentet tuaja do të procedohen nga stafi dhe pastaj në mënyrë elektronike të do të dërgohen (përmes kompjuterit) për tu aprovuar nga ARBK-ja. Nëse ARBK-ja e pranon aplikacionin ata do ta njoftojnë QKB-në Pastaj QKB-ja do ta shtyp certifikatën origjinale të regjistrimit. (ARBK-ja menjëherë informon autoritet e Tatimeve dhe Doganave për regjistrimin tuaj dhe për numrin tuaj unik të biznesit). QKB-ja do të ju informoj ju se sa do të zgjas procesi. Do të duhej të jetë e mundur ta merrni certifikatën në të njëjtën ditë, verifikoni në QKB tuaj pasi që mund të jetë e caktuar koha (p.sh 12 pd) që mund të jetë e garantuar për të marr dokumentet në të njëjtën ditë.

Hapi 6 Certifikata e regjistrimit vulozet nga QKB-ja dhe ju do të nënshkruani në librin e protokollit për të konfirmuar marrjen e dokumentit.

Hapi 7 Tani ju duhet të merrni një leje nga Komuna e cila ju lejon ju të filloni biznesin, por vetëm pasi që të kryhet inspektimi i lokalit tuaj dhe të vërtetohet se çdo gjë është në rregull. Duhet të bëhet një pagesë, shuma do të varet nga tipi i biznesit që ju do ta operoni. Stafi i QKB-së mund të ju jap juve informatat të pagesës. Stafi i QKB-së do të kontaktoj departamentin(tet) përkatës të lejeve dhe të caktoj vizitën e inspektorit të lejeve në vendin tuaj të biznesit.(shiko udhëzuesin për leje) Ju duhet të pajtoheni me këto marrëveshje.

Hapi 8 Stafi i QKB-së do të ju këshilloj rreth marrjes së një licence që varësisht nga biznesi i juaj mund të jetë apo mund të mos jetë e nevojshme. (shiko faqen e udhëzuesit për Licencim të Biznesit) Pasi që kjo ka gjasa të kërkoj të kontaktoni me Ministrin, QKB-ja juaj do ju këshilloj se si ta bëni këtë apo ata do ta bëjnë këtë në emër tuajin.

Shënim

Ka gjasa që pas themelimit të biznesit tuaj në një pikë në të ardhmen, ju të keni nevojë për të bërë ndryshime. Ndryshimet në biznes mund të bëhen për disa arsye, për shembull rritet biznesi dhe duhet të punësoni më shumë punëtorë, një drejtorë jep dorëheqje, për shkak të rritjes së biznesit përfshihen më shumë drejtor, apo një kompani e huaj ka dëshirë të investoj dhe kështu me radhë. Me ligj jeni të obliguar të njoftoni ARBK-në për ndryshimet e caktuara të biznesit, duke i dorëzuar dokumentet e nevojshme. Në paragrafin xx ju mund të shihni se për të cila ndryshime në biznesin tuaj ju duhet ta informoni ARBK-në. Procesi i dorëzimit të dokumenteve mund të përfundohet në QKB.

6. Themelimi i një biznesi kooperativë

Zakonisht ky lloj i biznesit në Kosovë themelohet vetëm nga fermerët. Për arsye se për shumë fermer është e zakonshme operimi në një mënyrë të vogël, gjë që zakonisht e bën më të vështir për të funksionuar si një biznes. Sidoqoftë, kur një grup i fermerëve "bashkëpunojnë" mes vete, ata mund të jenë të suksesshëm në gjenerimin e të ardhurave. Për shembull, "kooperativa" mund të blej materiale në sasi të mëdha gjë që ulë çmimet, ata mund të ndajnë pajisje, në veçanti për nevojat e pajisjeve sezonale dhe gjithashtu të ndihmojnë dhe përkrahin njëri-tjetrin në përgjithësi.

Kooperative me ligj njihet si një strukturë legale edhe pse ndryshon prej kompanisë private apo kompanisë me përgjegjësi të kufizuar. Tradicionalisht kooperativat janë bazuar në vlerat e vetë-ndihmës, vetë-përgjegjësisë, demokracisë, barazisë, paanësisë dhe solidaritetit. Kooperativat kontrollohen nga "anëtarët" të cilët në mënyrë aktive marrin pjesë në krijimin e politikave të tyre dhe marrjen e vendimeve. Anëtarët janë një grup i njerëzve të cilët mund ose të mos punojnë në mënyrë aktive në kooperativë. Kur të regjistrohet Kooperativa duhet të jenë së paku 5 "anëtarë".

Ju duhet të dini që kooperativa e juaj do të jetë me shumë shanse për sukses financiar, për këtë arsye duhet të planifikoni dhe më së miri është të merrni këshilla profesionale (shiko faqen xx ose pyet këshilltarin e QKB-së). Kur ju do të mendoni se biznesi do të jetë i suksesshëm, juve duhet të filloni ta organizoni biznesin. Hapi i par i juaji duhet të jetë krijimi i bordit të drejtorëve apo komitetin e menaxhimit të cilët mund të fillojnë të marrin vendime në lidhje me funksionimin e kooperativës së re. (Normalisht këto janë poste vullnetare që përfshijnë anëtarët) Zakonisht mjaftojnë pesë anëtar: Një kryetar, sekretar dhe tre anëtar të cilët pritet të jenë me eksperiencë dhe përgjegjës.

Pas themelimit, bordi apo komiteti duhet të vendos për strukturën demokratike të organizatës dhe të çdo kategorie të anëtarësisë që përdoret. Gjithashtu ata duhet të vendosin për rregullat që do të përdoren nga kooperativa dhe për vlerën e çdo kapitali të investuar nga anëtarët e saj. Me ligji duhet të ekzistoj një shumë (jo e përcaktuar) e kapitalit të aksioneve e cila duhet të deklarohet në regjistrim.

Pas përcaktimit të rregullave, kooperativës do ti duhet të bie dakord për një strukturë organizative për biznesin. Kjo duhet të mbulojë strukturën menaxhuese, rolet dhe përgjegjësit e stafit brenda kooperativës. Bordi apo komiteti gjithashtu do ta finalizoj planin e biznesit, për ta bërë kooperativën gati për regjistrim dhe fillim të tregtisë. Shumica e fitimit që është gjeneruar, që janë paret e mbetura pas pagimit të aksionarëve, stafit dhe çdo shpenzim është ri investuar në biznes. Disa do të përdoren si rezervë e keshit dhe parat e mbetura do të investohen në pajisje apo të ngjashme.

Kooperativat kanë status të veçantë tatimi.

Dokumentet e nevojshme për hapjen e Kooperativës janë

1. Plotësimi i formularit K0
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarëve
3. Kopja e letërnjoftimit e të gjithë Drejtorëve dhe të personave me pozitë në kompani varësisht prej llojit të aksioneve të tyre
4. Statuti i kooperativës
5. Kontrata e marrëveshjes për qira të lokalit tuaj me një palën e tretë, apo dokumentet e pronësisë së lokalit tuaj
6. Numri i doganës dhe kopja e licencës, VETËM nëse ju tanimë jeni importues apo eksportues
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë

7. Regjistrimi i ndryshimeve në Bizneset Ekzistuese

Ekzistojnë udhëzime për të ju ndihmuar juve në plotësimin e të gjithë formularëve të ARBK-së të cilat mund të gjinden në linkun për informata të QKB-së në faqen e internetit të Komunës tuaj (stafi i QKB-së do të ju ndihmoj juve)

Për të bërë ndryshime në biznesin tuaj ekzistues ju duhen këto dokumente si dhe t'i përdorni formularët përkatës, si mëposhtëm:

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të emrit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A1
2. Aneks Statutin
3. Vendimin për ndërrim të statutit
4. Vendim për ndërrim të emërtimit
5. Fotokopja e letërnjoftimit aksionarëve
6. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të adresës të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente

1. Plotësimi i formularit A3,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Të ceket edhe në vendim edhe në aneks statut, adresa e re
5. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
6. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
7. Fletëposedimin për pronë ose kontratën e qeras
8. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë
9. Letërnjoftimi i qiradhënësit
10. Vendimi për ndërrimin e adresës

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Tipit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A4,
2. Vendimi për të ndërrim të statutit
3. Të dorëzohet certifikata e biznesit origjinale
4. Statuti
5. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të numrit të punëtorëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A5,
2. Aneks Statuti
3. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
4. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
5. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë
6. Vendimi për ndërrimin e numrit te punëtoreve

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Kapitalit të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A6,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të kapitalit
4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
5. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Veprimtarive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A7,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
5. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë
7. Vendimi për ndërrimin e veprimtarive

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Pronarëve-Aksionarëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A8,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë
8. Vendimi për ndërrimin e aksionarëve

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Drejtorëve të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A9,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për shkarkim të drejtorit / ëve
4. Vendimi për emërtim të drejtorit / ëve të rinj
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopjet e letërnjoftimeve të drejtorit / ëve të shkarkuar dhe drejtorit / ëve të emëruar
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Njësive të Shoqërisë aksionare, Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Ortakërisë së kufizuar ose Kompanisë së huaj, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit A10,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Kontrata mbi shit-blerjen ose faljen e aksioneve
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopja e letërnjoftimit të aksionarëve

7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej €22 të paguhet në bankë
8. Vendimi për ndërrimin e njësave

Për çdo ndërrim (si dhe regjistrim të ri) që dëshironi të bëni në biznesin tuaj individual, ju duhet ta përdorin formularin B.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të emrit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
4. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të adresës së Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
4. Fletëposedimin për pronë ose kontratën e qeras
5. Letërnjoftimi i qiradhënësit
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për Ndërrim të tipit të Biznesit Individual dhe Ortakërisë së përgjithshme

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale
4. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës, për ndërrim të tipit të biznesit apo ortakërisë së përgjithshme
5. Marrëveshja në mes të ortakëve (nëse është ortakëri e përgjithshme)
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të numrit të punëtorëve në Biznes individual apo Ortakëri të përgjithshme:

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
4. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për shtimin apo heqjen e veprimtarive në Biznes Individual apo Ortakëri të përgjithshme

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
4. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrimin e pronarëve në Biznes individual apo Ortakëri të përgjithshme

1. Plotësimi i formulari B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës , për ndërrim të pronarit
4. Kopja e letërnjoftimit të pronarit të kaluar dhe pronarit të ri
5. Marrëveshja në mes të pronarëve
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrimin e drejtorit apo agjentit në Biznesin Individual apo Ortakëri të përgjithshme

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Kopja e letërnjoftimit të drejtorit apo agjentit
4. Vendimi për ndërrim të drejtorit, kurse për ndërrim të agjentit duhet një deklaratë
5. Kopja e certifikatës së biznesit
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për shtim apo heqje të njësisë në Biznesin Individual apo Ortakëri të përgjithshme

1. Plotësimi i formularit B
2. Kopja e certifikatës së biznesit
3. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
4. Kontrata ose fletëposedimi për njësinë , vetëm nëse nuk është në të njëjtin vend me bazën
5. Kopjen e letërnjoftimit të qiradhënësit
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 7 euro dhe të paguhet në bankë.

Dokumentet që janë të nevojshme për shuarje të biznesit individual ose ortakërisë së përgjithshme

1. Plotësimi i formularit D
2. Kopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
3. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës, për shuarjen e biznesit
4. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 5 euro dhe të paguhet në bankë.
5. Certifikata Origjinale e Biznesit

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrimin e tipit të biznesit nga N.T.P në SH.P.K:

1. Plotësimi i formularit A4
2. Të dorëzohet certifikata e biznesit, origjinale.
3. Vërtetimi prej Administratës Tatimore të Kosovës për ndërrimin e tipit të biznesit
4. Letërnjoftimi i pronarit (kopje).
5. Statuti mbi themelimin e SH.P.K-së.
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro euro dhe të paguhet në bankë.
7. Vendimi për themelimin e SH.P.K-s
8. Deklaratën mbi Agjentin

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Emrit të Kooperativës Bujqësore j ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K1
2. Aneks Statutin
3. Vendimin për ndërrim të statutit
4. Vendim për ndërrim të emërtimit
5. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
6. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të adresës të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente

1. Plotësimi i formularit K3
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Të çeket edhe në vendim edhe në aneks statut, adresa e re
5. Të dorëzohet certifikata e biznesit origjinale
6. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Kapitalit të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K6,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të kapitalit
4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
5. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Veprimtarive të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K7
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
5. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
6. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Pronarëve-Aksionarëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K8
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Kontrata mbi faljen ose shitjen e aksioneve
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve) – aksionarit (aksionarëve)
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Drejtorëve të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K9,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për shkarkim të drejtorit / ëve
4. Vendimi për emërim të drejtorit / ëve të rinj
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopjet e letërnjoftimeve të drejtorit / ëve të kaluar dhe drejtorit / ëve të ri.
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

Dokumentet që janë të nevojshme për ndërrim të Njësave të Kooperativës Bujqësore, ju duhet t'i posedoni këto dokumente:

1. Plotësimi i formularit K10,
2. Aneks Statuti
3. Vendimi për ndërrim të statutit
4. Kontrata mbi shit-blerjen ose faljen e aksioneve
5. Fotokopja e Certifikatës së biznesit
6. Fotokopja e letërnjoftimit të pronarit (pronarëve)
7. Fletëpagesa duhet të merret në ARBK në shumë prej 22 euro dhe të paguhet në bankë

8. Terminologjia e zakonshme e biznesit

Kushtet bizensore

Terminologjia biznesore

Janë disa fjalë që përdoren shpesh vetëm për situatat e biznesit, për shembull nga një bankë kur konsideron një kredi biznesi. Ju mund të kërkohet pyetje në lidhje me biznesin tuaj dhe këto terma janë të mundshme për t'u përdorur.

Qarkullimi

Ky term do të thotë fare thjeshtë, të gjitha paratë që janë krijuar nga shitjet. Ky term është më i zakonshëm që përdoret për periudhën e shitjes të bërë gjatë një viti. Për shembull, qarkullim im është € 25.000. Qarkullim nuk do të thotë përfitim apo ndonjë gjë tjetër, veç se para që hyjnë në biznes nga shitjet.

Fitimi

Ky term shumë shpesh nuk është përdorur me saktësi. Kjo do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave nga shitjet dhe shpenzimet. Për shembull:

TË ARDHURAT VJETORE NGA SHITJA	50,000
SHPENZIMET VJETORE	25,000
FITIMI VJEOTR	25,000

Duke përdorur shembullin e thjeshtë të mësipërme për biznesin e vogël, fitimi është 25.000. Pronari/ët e biznesit do të paguajë veten nga fitimi 25.000. Shpenzimet ndonjëherë përfshijnë pagat e pronarit /ëve, kjo varet se si pronari do të analizojnë informacion financiar. Kjo është arsyeja pse fitim mund të jetë çorientues. Është e këshillueshme që pronarët të mos përfshijnë pagat e tyre si pjesë e shpenzimeve. Është gjithashtu e këshillueshme për të shqyrtuar fitimin e bërë në bazë 3 mujore, që do të thotë se kontrolli i biznesit është shumë më efektiv.

Llogaritë biznesore

Kjo do të thotë se raporte financiare janë krijuar nga aktiviteti i biznesit tuaj. Kjo do të përfshijë detaje për të gjitha shitjet, të gjitha shpenzimet si pagesa e kredisë, pagat e punonjësve, furnizimet-blerjet, qiraja dhe kështu me radhë. Kjo është zakonisht një stërvitje vjetore, por është e varur mbi informacionet nga të dhënat e përditshme që është e këshillueshme për të mbajtur.

Kapitali

Kjo është thjesht, paraja që është përdorur për të blerë pajisje që zgjasin më gjatë. Kapitali zakonisht është i nevojshëm në fillimin e një biznesi për të blerë pajisje. Kapitali mund të jetë i fituar nga biznesi, si p.sh. nga mënyra e marrjes së një kredie.

Paratë rrjedhëse

Kjo është e paraja që rrjedh brenda dhe jashtë biznesit. Fjala 'Paratë rrjedhëse' zakonisht përdoret në dy kuptime, kur ka qarkullim pozitiv (të hyra të shumta) në kompani si dhe kur ka qarkullim negativ (dalje të shumta). Për shembull, ka raste kur një biznesi pagesa të shumta për shpenzime të pajisjeve, taksa, TVSH-ja. Ky shpenzim nuk mund të kompensohet nga të ardhurat e shitjes për periudhën, sikurse që është e paraqitur në tabelën e më poshtme:

Llogaritjet e biznesit mujor	
Shitja	5000
Shpenzimet	6000
Para ne dispozicion	-1000

Ky shembull do të përshkruhet si para rrjedhëse të këqija ose negative. Duke i analizuar modelet e shitjeve dhe shpenzimeve, ulje-ngritje të parave rrjedhëse, mund të parashikohen me saktësi të mjaftueshme.

Mjetet

Kjo ka të bëjë me të gjithë vlerën që biznesi e zotëron të tilla si pajisjet, ndërtesat dhe çfarë kreditorët i kanë borxh biznesit.

Detyrimet

Kjo i referohet asaj çka një kompani do t'i detyrohet borxhlinjve.

Kreditori

Kreditori është një person ose kompani që i ka borxh të holla biznesit. Për shembull, një biznes shet mallra të biznesit B. Biznes B nuk paguan Biznes A. Biznes B është kreditori i Biznesit A.

Debitori

Debitori është personi apo biznesi, që biznesit i detyrohen me të holla (i kanë borxh). Për shembull Biznes A blen të mira nga Biznesi B. Biznesi A nuk e paguan Biznesin B. Biznes B është debitor i Biznesit A.

Bilanci

Bilanci është ajo që një specialist i kontabilitetit prodhon për një biznes në një bazë vjetore dhe që është prodhuar për një ditë të veçantë në vit, si dhe një vit më parë. Kjo është një raport i cili përfshin çdo gjë në biznes, të gjitha pasuritë e balancuar kundër të gjitha detyrimet. Për këtë arsye është shumë i rëndësishëm sepse tregon nëse biznesi është në një pozicion të shëndoshë financiar apo jo.

Tabela -Terminologjia bazike për biznes

Terminologjia	Kuptimi
Qarkullim	Marrë të ardhurat totale nga shitja (përkrahur zakonisht në vit)
Të ardhurat neto	Të ardhurave, pasi të gjitha shpenzimet kanë zbritur
Fitimi neto	Paratë e mbetura pasi janë zbritur të gjitha shpenzimet nga të ardhurat (zakonisht llogaritjet tremujore apo vjetore)

Bilanci	Një llogari e vlerave të çdo gjëje që zotëron kompaia e balancuar me çdo gjë që kompania ka borxh
Mjetet (asetet)	Objektet që kompania i zotëron të tilla si ndërtesa, tokë dhe pajisje.
Kreditori	Një person apo biznes që ju ka borxh
Debitori	Personi apo biznesi që biznesi i juaj i ka borxh para
Detyrimet	Ngjashëm me Debitorin, një biznesit të zakonshëm kredia bankare është detyrim
Shpenzimet fikse	Shpenzimet që biznesi duhet të paguaj
Faturat e shitjes	Shitjet për të cilat është lëshuar fatura por që nuk është paguar
Paratë rrjedhëse	Një analizë ose llogaritje e parave të marra në krahasim me që dalin jashtë nga biznesi
Llogaritë vjetore	Analizë financiare e kompanisë në fund të një periudhe 12 mujore
Drejtori i kompanisë	Një person i cili është i regjistruar si pronar, pjesë e një kompanie të kufizuar dhe ka përgjegjësi ligjore për kompaninë

9. Shpjegime rreth tatimit për bizneset

Për të gjitha detajet, ju lutem referojuni web faqen e Agjencionin Tatimor të Kosovës:

http://www.atk-ks.org/shqip/Tatimet/fajllat/tak/Doracak_2006_A.pdf

Informata bazike

Korporatë, Individuale dhe Partneriteti i Përgjithshëm

Në qoftë se biznesi juaj është i regjistruar si një "korporatë" apo kompani e kufizuar, ju jeni të detyruar me ligj të paguani "Tatimin për korporatë", i cili është 10%. Gjithashtu nëse ju jeni një ortakëri e përgjithshëm ose të biznesit individual dhe qarkullimi juaj (shih seksionin x për përcaktimin e qarkullimit) është € 50,001 ose më shumë, atëherë i njëjti sistemi i taksave për korporatë zbatohet edhe për ju.

Juve do të ju duhet të paraqitni llogaritë tuaja tregtare dhe të plotësoni formularin vullnetar për deklaratën tatimore i cili mund të merret në zyrën lokale tatimore të qytetit tuaj. Është mjaft komplekse për të llogaritur fitimin tuaj të saktë në të cilën ju do të tatoneni, prandaj është e këshillueshme që të angazhohet një kontabilist profesional..

Tatimi mbi të ardhurat për korporatë duhet të paguhet çdo tre muaj, si paradhënie, duke u bazuar në të ardhurat neto tremujore. Partneriteti Individual dhe i Përgjithshëm me një qarkullim vjetor më pak se sa 50.001 €, nuk janë subjekt i tatimit për Korporatën.

Zyrat Tatimore e Kosovës mund të gjendet në faqen e saj të internetit:

Marrja e informacioneve tatimore

